



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:011285 **C. nr. 186/2022**
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05493167

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, me bashkëpunëtorin profesional I.S. në çështjen juridike kontestuese të inicuar me padi nga ana e paditësve A.H., E.Sh., M.Sh., S.L.K., M.C., M.J. dhe M.B. të cilët me autorizim i përfaqësojnë N.M. dhe D.Sh. avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shujtave ditore, me vlerë të kontestit 2,590.00 euro, me datë 22 Mars 2024, morri këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. MIRATOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve A.H., E.Sh., M.Sh., S.L.K., M.C., M.J. dhe M.B.

II. DETYROHET e paditura, Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që paditësve:

- Paditëses së parë A.H. në emër të kompensimit të shujtave ditore, për periudhën kohore për vitin 2021 për 185 ditë pune t'ia kompensoj shumën prej 370.00 (treqind e shtatëdhjetë) euro.
- Paditëses së dytë E.Sh. në emër të kompensimit të shujtave ditore, për periudhën kohore për vitin 2021 për 185 ditë pune t'ia kompensoj shumën prej 370.00 (treqind e shtatëdhjetë) euro.
- Paditësen e tretë M.Sh. në emër të kompensimit të shujtave ditore, për periudhën kohore për vitin 2021 për 185 ditë pune t'ia kompensoj shumën prej 370.00 (treqind e shtatëdhjetë) euro.
- Paditësen e katërt S.L.K. në emër të kompensimit të shujtave ditore, për periudhën kohore për vitin 2021 për 185 ditë pune, t'ia kompensoj shumën prej 370.00 (treqind e shtatëdhjetë) euro.
- Paditësen e pestë M.Ç. në emër të kompensimit të shujtave ditore, për periudhën kohore për vitin 2021 për 185 ditë pune, t'ia kompensoj shumën prej 370.00 (treqind e shtatëdhjetë) euro.
- Paditësen e gjashtë M.J. në emër të kompensimit të shujtave ditore, për periudhën kohore për vitin 2021 për 185 ditë pune, t'ia kompensoj shumën prej 370.00 (treqind e shtatëdhjetë) euro.
- Paditësen e shtatë M.B. në emër të kompensimit të shujtave ditore, për periudhën kohore për vitin 2021 për 185 ditë pune, t'ia kompensoj shumën prej 370.00 (treqind e shtatëdhjetë) euro.

Në shumën e përgjithshme prej 2,590.00 euro (dymijë e pesëqind e nëntëdhjetë) euro, me kamatë ligjore prej 8%, që nga data e parashtrimit të padisë më datë 20.01.2022, e deri në pagesën definitive e në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura që paditësve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 333.00 (treqind e tridhjetë e tre) euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit A.H., E.Sh., M.Sh., S.L.K., M.C., M.J. dhe M.B. përmes të autorizuarve të tyre N.M. dhe D.Sh. avokat nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 20 Janar 2022, kanë parashtruar padi, të cilën padi e kanë precizuar me datën 14 Dhjetorë 2022, në kuptimin objektiv, me objekt kontesti kompensimin e shujtave ditore, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, me vlerë të kontestit 2,590.00 (dymijë e pesëqind e nëntëdhjetë) euro.

Në padi palët paditëse kanë theksuar se paditësit kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë si mësimdhënës pranë SHFMU "Emin Duraku" në Prizren, Komuna e Prizrenit, duke llogaritur këtë periudhë të punës paditësve ju takon e drejta e kompensimit të ushqimit në punë, për një ditë pune në shumën prej 2 (dy) euro në bazë të drejtës që rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës, e datës 22.01.2021. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve lidhur me kompensimin e shujtave ditore. Ka theksuar se duke u bazuar në njoftimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/488 të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2022 padia dhe kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar. Ka theksuar se paditësit nuk kanë ofruar prova që janë anëtarë të sindikatës dhe i kanë kaluar procedurat administrative sepse nuk i kanë vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës dhe nuk i kanë shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, po ashtu me këto veprime i shkaktajnë Komunës së Prizrenit shpenzime të mëdha, sepse e obligojnë që t'ia paguajë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Po ashtu thekson se në mungesë të alokimit të mjeteve nga ana e institucioneve përgjegjëse në këtë rast nga Ministria e Arsimit, e cila është dashur të filloj realizimin e të drejtave që dalin nga KKAK, duke planifikuar buxhet në bashkërendim me Ministrinë e Financave e cila nuk ka caktuar kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017. Andaj, Komuna e Prizrenit rrezikon planifikimin buxhetor dhe në këtë mënyrë nuk mund të veprojë në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin nr.08/L-193 sa i përket tejkalimeve buxhetore të planifikuara për vitin 2023. Po ashtu ka theksuar se pretendimet e paditësve janë në kundërshtim me nenin 90 para.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës nr.03/L-212, sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarave, dhe në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënës dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Nga të gjitha të cekurat ka kërkuar që gjykata të nxjerr aktgjykim dhe të refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes e miratoj kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, respektivisht në SH.F.M.U. “Emin Duraku” në Prizren.

Gjykata përmes vërtetimit të datës 10.12.2021, të lëshuar nga ana e të paditurës, ka vërtetuar faktin se paditëset A.H., E.Sh., M.Sh., S.L.K., M.C., M.J. dhe M.B. si mësimdhënëse pran SH.F.M.U. “Emin Duraku” në Prizrn, për vitin 2021, kanë nga 185 ditë pune.

Vërtetimin e lartcekura, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*. Andaj meqë ky dokument është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cila si të tillë është e pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimi i lëshuara nga ana e SH.F.M.U. “Emin Duraku”, në Prizren, si provë me të cilën vërtetohet fakti lidhur me ditët e prezencës në punë të paditësve, gjykata ia fali besimin e plotë, e nga e cila vërtetoi faktin se për vitin 2021 të gjithë paditëset si nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, kanë nga 185 ditë vijueshmërie në punë.

Me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021, e më saktësisht në dispozitivin 35 paragrafi 7, të KKAK-së është paraparë se *“Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim”*.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësve si mësimdhënëse t’ia paguaj kompensimin për ushqimin gjatë punës, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht ditët e punës për paditësit, të vërtetuara nga vet punëdhënësi, është që secili paditës i kanë nga 185 ditë pune, gjykata i ka shumëzuar me shumën prej 2 euro të parapara si në nenin 35 paragrafi 7 të KKAK-së, duke ia njohur shumën e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitivin e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitivë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 398 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësve është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Në këtë çështje kontestimore gjykata i referohet nenin 7.1 të LPK-së ku përcaktohet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”* Edhe në nenin 319.1 të LPK-së rezulton kërkesa që *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.*

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 463 të LPK-së lidhur me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve e datës 18 mars 2017, dhe atë për përpilimin e padisë, shumën prej 312 euro, dhe për taksën gjyqësore shumën prej 21.00 euro, gjithsej shumën prej 333.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe nenit 398 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

C.nr.186/22, me datë 22 Mars 2024

B.profesional
Ilir Sërtollaj

Gjyqtari
Atdhe Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.